

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
Nr. 19624/4 VENDIMI

V E N D I M

I G J Y Q T A R J T T E V E T E M

Në Tiranë, sot më datë 8. 4. 2002, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë E. 307, pasi mora në shqyrtim kërkesën e kërkuessit Bilbil Alimadhi, administratori shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" sh.p.k.

K O N S T A T O V A

Se shoqëria "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" sh.p.k. është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 19624 date 17.06.98 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Ortak i Vetëm i shoqërisë është z.Vebi Velija.

Ortaku i Vetëm i shoqërisë me Vendimin nr. 5 datë 27.03.2002 ka vendosur:

1. Te aprovoje raportin e ekspertit kontabel te autorizuar z. Teit Gjini per vleresimin e zmadhimit te kapitalit te shoqerise.
2. Te rrise kapitalin themeltar te shoqerise nga 1,000 (njemije) USD ne 226,612,035 (Dyqindenzetegjashtemilion e gjashteqindedybedhjetemije e tridhjetepese) Leke.
3. Numri I kuotave ne kapitalin themeltar do te behet, 453 (katerqindepesedhjetetere) kuota, ndersa vlere nominale e nje kuote do te jete 500,000 (peseqindmije) leke.
4. Neni 12 i statutit te shoqerise te ndryshohet si me poshte: "Kapitali themeltar I shoqerise është 226,612,035 (Dyqindenzetegjashtemilion e gjashteqindedybedhjetemije e tridhjetepese) Leke. Ky kapital mund te shtohet te pakesohet ose te transferohet ne perputhje me statutin e shoqerise si dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi."

Kërkesa e tij është e drejtë, e bazuar në ligj e në Statut dhe duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E

Në bazë të Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës.  
Depozitim në Rregjistrin Tregtar të Vendimit Nr.5 datë 27.03.2002 të Ortakut të Vetëm të shoqërisë "Albania Tabak Fabrika e re e Cigareve" sh.p.k. dhe te aktit te ekspertimit per vleresimin e kontributeve per zmadhimin e kapitalit.

Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit Tregtar të bëjë shënime të përkatëse në skedën e shoqërisë në kolumnën \_\_\_\_\_.

**GJYQTARE**

E. Baj

*(Signature)*